




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/07
Datë: 06.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/07
Datë: 06.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 6 paragrafi 4. të Ligjit nr.05/L-081 për Energjinë (GZ/Nr. 24/13 korrik 2016), duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017, dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2017-2026.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Strategjinë nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/07
Datë: 06.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 49 paragrafi 2.2. të Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale (GZ/Nr. 80/2010), duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017, dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për konfirmimin e interesit të përgjithshëm për shfrytëzimin e thëngjillit nga Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A (KEK).
2. Konfirmimi i interesit të përgjithshëm nga pika 1 e këtij vendimi bëhet me qëllim të krijimit të bazës juridike për lëshimin e licencës nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, konform Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale, Korporatës Energjetike të Kosovës për ushtrimin e aktiviteteve përkatëse të saj në interes të përgjithshëm publik.
3. Obligohet Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A (KEK), për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Ramush HARADINAJ

Kryeministri i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/07
Datë: 06.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017, dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Ndërmarrjet Publike.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Koncept Dokumentit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/07
Datë: 06.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017, dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni i Ministrave për Ndërmarrjet Publike, në këtë përbërje:
 - 1.1. Ministri i Zhvillimit Ekonomik, kryesues;
 - 1.2. Ministri i Financave, anëtar;
 - 1.3. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, anëtar;
 - 1.4. Ministri i Infrastrukturës, anëtar; dhe
 - 1.5. Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, anëtar.
2. Komisioni sipas pikës 1. të këtij vendimi do t'i paraqesë Qeverisë së Republikës së Kosovës propozime ose vërejtje për Ndërmarrjet Publike.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi nr. 05/03 i datës 19.12.2014, vendimi nr. 08/133 i datës 05.06.2013 dhe vendimi nr. 05/18 i datës 08.06.2011.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/07
Datë: 06.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017, dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për negocimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e projektit për autostradën Kijevë - Zahaq.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Financave të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/07
Datë: 06.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017, dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REFORMËS SË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE STRUKTURAVE PËRGJEGJËSE PËR TË KOORDINUAR, MONITORUAR DHE ZBATUAR DOKUMENTET STRATEGJIKE TË REFORMËS SË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i këtij vendimi është:

- 1.1. Themelimi, funksionimi dhe përbërja e Këshillit të Ministrave për Reformën e Administratës Publike (në tekstin në vijim KMRAP), i cili do të jetë struktura kryesore përgjegjëse për sigurimin e zbatimit të dokumenteve strategjike të Reformës së Administratës Publike.
- 1.2. Themelimi dhe funksionimi institucional i strukturave përgjegjëse për të koordinuar, monitoruar dhe zbatuar dokumentet strategjike të Reformës së Administratës Publike si dhe strukturave përgjegjëse për zbatimin e tyre.

Neni 2
Përbërja e KMRAP

1. KMRAP ka këtë përbërje:

- 1.1. Ministri i Ministrisë së Administratës Publike (kryesues);
- 1.2. Ministri i Ministrisë së Financave (anëtar);
- 1.3. Ministri i Ministrisë për Integrim Evropian (anëtar)
- 1.4. Ministri i Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal (anëtar)
- 1.5. Ministri i Ministrisë për Tregti dhe Industri (anëtar)
- 1.6. Ministri i Ministrisë së Drejtësisë (anëtar)
- 1.7. Zyra e kryeministrit - këshilltar politik (anëtar)

2. KMRAP ushtron detyrat dhe përgjegjësitë si vijon:
 - 2.1. Drejton dhe mbikëqyrë në nivel politik të gjitha çështjet që ndërlidhen me procesin e zbatimit të dokumenteve strategjike të RAP;
 - 2.2. Shqyrton raportet periodike të progresit mbi zbatimin e dokumenteve strategjike të RAP;
 - 2.3. Zgjidhë çështjet që pengojnë dhe/apo vështirësojnë progresin e zbatimit të dokumenteve strategjike të RAP, në pajtim me politikat qeveritare;
 - 2.4. Propozon në Qeveri për plotësim-ndryshimin e dokumenteve strategjike të RAP;
 - 2.5. Vendosë për adresimin e çështjeve në Qeveri që ndërlidhen me zbatimin e dokumenteve strategjike të RAP;
 - 2.6. Kontribuon dhe jep këshilla dhe udhëzime për Qeverinë dhe Kuvendin për procesin e racionalizimit të agjencive dhe vendosjen e linjave të llogaridhënies në Administratën Publike;
 - 2.7. Në nivelin politik, stimulon dhe monitoron përmbushjen e indikatorëve të kontratës për mbështetje buxhetore të sektorit.
3. Takimet e KMRAP ftohen nga Kryesuesi dhe mbahen kur gjykohet që ka çështje për t'u shqyrtuar, por jo më pak se një (1) herë në tre (3) muaj. Për mbajtjen e takimit të KMRAP të pranishëm duhet të jenë së paku katër (4) nga shtatë (7) anëtarët me të drejtë vote. Në rast mungese të anëtarëve nga paragrafi 1.2 deri 1.6 i këtij neni në takimet e KMRAP marrin pjesë zv. ministrat përkatës.
4. Kryesuesi i KMRAP mund të ftojë në takime edhe Ministra apo përfaqësues të institucioneve dhe/apo organizatave tjera, nëse çështjet që pritet të shqyrtohen lidhur me zbatimin e dokumenteve strategjike të RAP ndërlidhen me fushë veprimtaritë e institucioneve që ata përfaqësojnë.
5. Në takimet e KMRAP marrin pjesë edhe Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Administratës Publike, si dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Financa, të tre në cilësinë e përgjegjësve nga fushat respektive. Po ashtu edhe Udhëheqësi i Departamentit për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike në cilësi të vëzhguesit. Këta mund të debatojnë për çështjet që ngriten për zbatimin e dokumenteve strategjike të RAP por pa të drejtë vote.
6. Në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, propozimet e KMRAP miratohen me shumicë votash dhe përmbajnë udhëzime të qarta për zgjidhjen e arritur për çështjen e shqyrtuar dhe veprimet e mëtutjeshme që duhen ndërmarrë nga ministria apo institucioni përkatës për zbatimin e vendimit në kohën e caktuar.
7. Propozimet procedohen për Qeveri për aprovim kur kërkohet një aprovim i tillë.

Neni 3

Strukturat përgjegjëse për zbatimin e dokumenteve planifikuese-strategjike

1. Strukturat përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të dokumenteve planifikuese-strategjike janë institucionet vijuese:
 - 1.1. Zyra e Kryeministrit (ZKM), përgjegjëse për zhvillimin dhe koordinimin e politikave dhe legjislacionit (koordinator, Sekretari i Përgjithshëm i ZKM);

- 1.2. Ministria e Administratës Publike (MAP), përgjegjëse për shërbimin civil/publik dhe burimet njerëzore, ofrimin e shërbimeve publike dhe llogaridhënien (koordinator, Sekretari i Përgjithshëm i MAP); dhe
- 1.3. Ministria e Financave (MF) përgjegjëse, për menaxhimin e financave publike (koordinator, Sekretari i Përgjithshëm i MF);
2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve përgjegjëse përkatëse obligohen të ndër marrin hapa të menjëhershëm për planifikimin, hartimin dhe zbatimin e aktiviteteve të dokumenteve planifikuese.
3. Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni dhe pas çdo takimi të punës, Kryesuesi i KMRAP informohet nga DMRAP për konkluzionet dhe rekomandimet që dalin nga takimet.
4. Kryesuesit e GP-ve (koordinatorët) raportojnë në takimet e KMRAP mbi progresin dhe sfidat që evidentohen në takimet e Grupeve veç e veç.
5. Koordinatorët e përcaktuar me paragrafin 1 të këtij neni, veprojnë në pajtim me legjislacionin në fuqi si dhe sigurohen që zbatimi i aktiviteteve të realizohet me cilësi të lartë dhe në afatin e përcaktuar kohor në vet dokumentet planifikuese.
6. Detyrat dhe përgjegjësitë e Koordinatorëve (SP-ve) përgjegjës janë:
 - 6.1. Sigurimi i zbatimit të vendimeve të KMRAP me cilësi të lartë dhe me shpejtësi;
 - 6.2. Shqyrtimi i performancës dhe koordinimi i veprimeve për zbatimin e plotë dhe efektiv të aktiviteteve të dokumenteve planifikuese;
 - 6.3. Identifikimi dhe propozimi i masave procedurale/teknike që duhet ndërmarrë për zbatimin e plotë dhe efektiv të aktiviteteve të dokumenteve planifikuese;
 - 6.4. Evidentimi i sfidave dhe ngecjeve eventuale gjatë procesit të zbatimit të dokumenteve planifikuese dhe propozimi i zgjidhjeve për tejkalimin e tyre;
 - 6.5. Përcaktimi i prioriteteve për zbatimin e aktiviteteve të dokumenteve planifikuese, sipas nevojës;
 - 6.6. Diskutimi i buxhetit të nevojshëm për zbatimin e aktiviteteve të caktuara;
 - 6.7. Harmonizimi i dokumenteve planifikuese në mes vete dhe me dokumentet tjera strategjike e planifikuese të Qeverisë dhe ato të Integritimit Evropian.
 - 6.8. Hartimi dhe përpilimi i materialeve të ndryshme sipas çështjeve dhe temave që KMRAP ka për agjendë diskutimi, në fushat përkatëse; dhe
 - 6.9. Çdo fund vit, hartojnë nga një raport përmbledhës vjetor mbi të arriturat, sfidat dhe rekomandimet që rrjedhin nga procesi i RAP në fushat e tyre përkatëse.
7. Koordinatorët, në takimet e tyre punës për RAP sigurohen se kanë përfshirë edhe nga një përfaqësues nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe atë të Ministrisë së Integritimit Evropian.
8. Në pamundësi objektive të pjesëmarrjes në takimet e tyre të punës si dhe në takimet e KMRAP, koordinatorët mund të autorizojnë një drejtor departamenti nga institucioni përkatës që të merr pjesë në këto takime.
9. Sigurohen që DMRAP, me një anëtar është përfshirë në takimet e punës për hartimin e dokumenteve planifikuese të RAP.

Neni 4

Struktura përgjegjëse për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të dokumenteve planifikuese-strategjike

1. Struktura përgjegjëse për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të dokumenteve strategjike është Departamenti për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike (DMRAP) pranë Ministrisë për Administratë Publike.
2. Për të koordinuar dhe monitoruar zbatimin e dokumenteve planifikuese për RAP dhe në pajtim me dispozitat e këtij vendimi, DMRAP ushtron detyrat dhe përgjegjësitë si vijon:
 - 2.1. Ofron informata cilësore, të sakta dhe të vazhdueshme mbi zbatimin e dokumenteve strategjike për Kryesuesin e KMRAP, Ministrin e Administratës Publike;
 - 2.2. Përmbledh raportet e marra nga koordinatorët (Sekretarët e Përgjithshëm, përkatës) për progresin e arritur në fushat përkatëse të RAP dhe dërgohen në DMRAP;
 - 2.3. Në fund të çdo viti kalendarik, përgatit një raport përmbledhës vjetor dhe vlerëson realizueshmërinë e dokumenteve planifikuese-strategjike dhe në bashkërendim me Sekretarët e Përgjithshëm (koordinatorët) përgjegjës propozon drejtimit e përditësimit të dokumenteve strategjike;
 - 2.4. Mbi bazën e problematikës së nxjerrë nga raportet përmbledhëse, kërkesave të koordinatorëve dhe/apo çështjeve të tjera që përmirësojnë ecurinë e procesit të zbatimit të dokumenteve planifikuese-strategjike, propozon projekt-agjendën e takimeve të KMRAP dhe e përcjell për shqyrtim dhe miratim tek Kryesuesi i KMRAP;
 - 2.5. Formulon konkluzionet dhe vendimet e mbledhjes së KMRAP të cilat, pas miratimit nga Kryesuesi, i përcjell brenda një (1) jave për informacion dhe veprime të mëtutjeshme tek institucionet e përfshira në problematikën e agjendës së takimeve;
 - 2.6. Bënë monitorime të rregullta dhe/apo ad-hoc sipas rasteve për verifikimin e rezultateve të paraqitura në raporte, dhe rezultatet e monitorimit i paraqet pranë KMRAP;
 - 2.7. Ushtron veprimtari të ndërsjellë informuese, monitoruese, koordinuese dhe ndihmuese pranë të gjitha strukturave përgjegjëse për zbatimin e dokumenteve strategjike; dhe
 - 2.8. DMRAP, po ashtu kryen rolin e sekretariatit për KMRAP;

Neni 5

Shfuqizimi dhe hyrja në fuqi

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi nr. 05/09 i datës 21.01.2015 dhe vendimi nr. 09/13 i datës 12.02.2015 i Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/07

Datë: 06.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017, dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 40,000,00 (katërdhjetëdhjetë mijë) euro, për përmbushjen e kontributit vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2017 në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal, me seli në Sarajevë, respektivisht në buxhetin e Sekretariatit të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal. Republika e Kosovës bën pjesë në grupin prej 4 % të shumës totale të vendeve të Evropës Juglindore (përcaktuar formalisht në Takimin e Tryezës Rajonale të Paktit të Stabilitetit për EJL në Bukuresht, Nëntor 2006).
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën-programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, nën kategoria ekonomike e rezervës me kod 38010 dhe transferohen në Ministrinë e Financave, nën-programi i Thesarit me kod 11200, kategoria subvencione dhe transfere, në nën kategorinë ekonomike - transfere për qeveri tjera me kod 22100.
3. Obligohet Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/07
Datë: 06.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017, dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për negocimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim Teknik për fonde shtesë për vitin 2017, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Financave të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/07
Datë: 06.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017, dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për negocimin e Marrëveshjes së Grantit në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Qeverisë Federale të Gjermanisë, e përfaqësuar nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW), për rritjen e kapitalit të garancisë së Fondit Kosovar për Garanci Kreditore në vlerë prej 5.45 milionë euro.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Financave të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/07
Datë: 06.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017, dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për negocimin e Marrëveshjes së Grantit - Projekti për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore 10, në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Financave të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/07
Datë: 06.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017, dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për negocimin e Marrëveshjes së Grantit në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Qeverisë Federale të Gjermanisë, e përfaqësuar nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW), për rritjen e kapitalit të garancisë së Fondit Kosovar për Garanci Kreditore në vlerë prej 2 milionë euro.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Financave të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/07
Datë: 06.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 të Ligjit nr. 03/L-220 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-112 për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017, dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit të Qeverisë nr. 16/20 të datës 24.03.2015

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave për të liruar nga tatimi i akcizës të gjithë prodhuesit që importojnë vet apo përmes kontraktuesit të cilët janë të autorizuar nga Administrata Tatimore e Kosovës për shtyrje të TVSH-së për lëndë të parë, për të gjitha burimet e energjisë të cilat përdoren për qëllime të prodhimit.
2. Vendimi Nr. 16/20 i Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 24.03.2015 ndryshohet si vijon:
 - 2.1. Pika 7, ndryshon si vijon: lirohen nga tatimi i akcizës të gjithë prodhuesit pavarësisht a importojnë vet apo përmes kontraktuesve, për nevoja të prodhuesve të gjitha burimet e energjisë të parapara me paragrafin 3 të Vendimit të Qeverisë nr. 16/20 të datës 24.03.2015 dhe atyre të parapara me Aneksin A të Ligjit nr. 03/L-220 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-112 për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë të cilat përdoren për qëllime të prodhimit.
3. Dogana e Kosovës do të lirojë subjektin e lartë shënuar në pikën 2.1 të këtij vendimi, me rastin e deklarimit të mallit për doganim përmes Deklaratës Unike Doganore, dhe në rastet e importit nga kontraktori në rubrikën nr. 9 të deklaratës do të vendoset emri dhe numri fiskal i prodhuesit i cili është i autorizuar nga Administrata Tatimore e Kosovës për shtyrje të TVSH-së për lëndë të parë. Dogana e Kosovës do të mbajë evidencë të saktë përmes sistemit ASYCUDA, dhe për çdo lirim në kohë reale do të njoftohet Administrata Tatimore e Kosovës për qëllim të implementimit të legjislacionit në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Financave dhe Dogana e Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendimi hyn në fuqi pas konsultimit me Komisionin për Buxhet dhe Financa.

6. Zbatimi i këtij vendimi fillon më 01 janar 2018.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/07

Datë: 06.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 të Ligjit nr. 04/L-163 për Mallrat e Liruara nga Tatimi Doganor dhe Mallrat me tarifë Zero të Tatimit Doganor, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave për lirim nga tatimi doganor të gjithë prodhuesit që importojnë vet apo përmes kontraktuesit të cilët janë të Autorizuar nga Administrata Tatimore e Kosovës për shtyrje të TVSH-së për:
 - 1.1. Lëndën e parë që përdoret në proces të prodhimit;
 - 1.2. Gjysmë produktet të cilat përdoren në proces të prodhimit;
 - 1.3. Të gjitha linjat e makinerive prodhuese të cilat përdoren në hapësira prodhuese për prodhim;
 - 1.4. Pajisjet e teknologjisë së informacionit.
2. Dogana e Kosovës do të lirojë subjektin e lartë shënuar në pikën 1. të këtij vendimi, me rastin e deklarimit të mallit për doganim përmes Deklaratës Unike Doganore, dhe në rastet e importit nga kontraktori, në rubrikën nr. 9 të deklaratës do të vendoset emri dhe numri fiskal i prodhuesit i cili është i autorizuar nga Administrata Tatimore e Kosovës për shtyrje të TVSH-së për lëndë të parë. Dogana e Kosovës do të mbajë evidencë të saktë përmes sistemit ASYCUDA dhe për çdo lirim në kohë reale do të njoftohet Administrata Tatimore e Kosovës për qëllim të implementimit të legjislacionit në fuqi.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Dogana e Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi me datën 01 Janar 2018.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/07

Datë: 06.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Nisma e Ministrisë së Financave për aderimin në Konventën ndërkombëtare mbi thjeshtëzimin dhe harmonizimin e procedurave doganore.
2. Përgjatë negociimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Financave obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/07
Datë: 06.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Nisma e Ministrisë së Financave për aderimin në Konventën ndërkombëtare mbi harmonizimin e përshkrimit të mallrave dhe sistemin e kodimit.
2. Përgjatë negociimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Financave obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/07

Datë: 06.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 64 të Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi dhe të nenit 11 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017, dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Formohet Bordi Drejtues i Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, në përbërje të:
 - 1.1. Dr. Shemsi Veseli - Qendra Klinike Universitare e Kosovës;
 - 1.2. Dr. Fatmir Dragidella - Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës;
 - 1.3. Dr. Naser Ramadani - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike;
 - 1.4. Një (1) përfaqësues - Spitalet e përgjithshme, në bazë të rotacionit dhe përmbushjes së indikatorëve të kualitetit të shërbimeve shëndetësore;
 - 1.5. Dr. Mirdita Hajdari - Shërbimet e kujdesit parësor shëndetësor, në bazë të propozimit të Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës;
 - 1.6. Z. Ardian Ferizi - Ministria e Shëndetësisë;
 - 1.7. Një (1) ekspert i menaxhmentit shëndetësor, i zgjedhur në bazë të konkursit publik.
2. Bordi Drejtues i përgjigjet dhe i jep llogari Qeverisë nëpërmjet Ministrit të Shëndetësisë.
3. Mandati i kryesuesit të Bordit është 1 (një vjeçar) i cili zgjidhet në bazë të parimit të rotacionit nga anëtarët e tij.
4. Mandati i anëtarëve të Bordit Drejtues është 3 (tre) vjeçar.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Për shkak të përfundimit të mandatit 3 (tre) vjeçar të Bordit të SHSKUK-së dhe me qëllim të funksionimit të Bordit të SHSKUK-së dhe mbarëvajtjes së gjithmbarshme të punëve, përfshirë aktivitetet shëndetësore dhe administrative të njësive organizative të SHSKUK-së.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 18/07

Datë: 06.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017, dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme për përmbushjen e të gjitha detyrimeve që dalin nga marrëveshjet/memorandumet e mirëkuptimit (të lidhura nga MPJ me shoqata, apo të ngjashme) nëpërmjet të cilave kjo Ministri ka hy në obligime financiare me qëllim të mbështetjes dhe përkrahjes së tyre.
2. Përmbushja e detyrimeve nga pika 1. e këtij vendimi të bëhet brenda afateve kohore të caktuara dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
3. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë